

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6899
E premte, 19 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Ambasadori
amerikan ia përsërit
Kurtit themelimin
e Asociacionit **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHMITARËT E PROKURORISË NË GJYKATËN SPECIALE VAZHDOJNË TË DËSHMOJNË NË SEANCA TË MBYLLURA NË RASTIN E THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNQIT **FAQE 4-5**

MBROJTJA E THAÇIT DEL KUNDËR SEANÇAVE TË MBYLLURA: DUAM TË MERRET VESH E VËRTETA



Në Gjykatën Speciale në Hagë është duke vazhduar procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Deri më tani janë marrë në pyetje pesë dëshmitarë të ZPS-së. Këta dëshmitarë kanë dhënë dëshmitë e tyre në seanca të

mbyllura për publikun. Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, është shprehur i shqetësuar për mbajtjen e seancave të mbyllura. Ai ka thënë se një gjë e tillë është duke i shkakuar probleme mbrojtjes së liderëve

të UÇK-së. Ai ka kërkuar nga trupit gjyqësor i Speciales që seancat të jenë publike. Në këtë kontekst, avokati Kehoe ka thënë se duan të merret vesh e vërteta në lidhje me këtë proces gjyqësor



**CHOLLET U TELEFONON KURTIT
DHE VUÇIQIT PËR ZBATIMIN E
MARRËVESHJES BAZË TË DIALOGUT.** **FAQE 7**

**PASIGURIA E TË RINJVE
UL NDJESHËM MARTESAT
NË SHQIPËRI** **FAQE 7**



AKTUALE



**RIVALI I ERDOGANIT: TË GJITHË
MIGRANTËT DO T'I DËRGOJ NË
SHTËPI** **F. 2**

**PROKURORIA E PRISHTINËS
PRANON KALLËZIM PENAL
NDAJ "VISA METRIC"** **F. 7**

**HAPET PAVIJONI I KOSOVËS NË
EDICIONIN E 76 TË FESTIVALIT TË
KANËS** **F. 6**

**VUÇIQI: KRYETARËT E KOMUNAVE
NË VERI TË KOSOVËS NUK
DO T'I PRANOJMË KURRË** **F. 6**

EKONOMI



HAPET PANAIRI EXPOKOS **F. 8**

**PRODHIMET ORGANIKE TË
KOSOVËS NË TREGJET EVROPIANE** **F. 8**

SPORT



**SONTE FINALJA E PLEJOFIT NË MES
TË ISTOGUT DHE VUSHTRRISË** **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rivali i Erdoganit: Të gjithë migrantët do t'i dërgoj në shtëpi

ANKARA, 18 MAJ - Lideri i opozitës turke, Kemal Kilicdaroglu, është zotuar të enjten se do t'i kthejë nëpër vendet e tyre miliona migrantë në rast se fiton në balotazhin e 28 majit. Ai është në garë me presidentin aktual Rexhep Tajip Erdogan. Këto janë deklaratat e para të tij që prej mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale më 14 maj.

Në raundin e parë asnjëri kandidat nuk ka arritur të fitojë mbi 50 për qind të votave për pozitën e presidentit. Megjithatë, performanca e Kilicdaroglut ka qenë më e mira e një kandidati opozitar përgjatë dy dekadave të fundit. Kilicdaroglu, 74-vjeçar, ka folur të enjten në favor të votuesve të

krahut të djathtë.

Ai, po ashtu, pritet të takohet edhe me Sinan Oganin - figurë e së djathtës ekstreme, i cili i ka fituar 5.2 për qind të votave në garën për president.

Të enjten ai ka folur me ton më të ashpër sesa në fazën e parë të fushatës. "Erdogan, ju nuk i keni mbrojtur kufijtë dhe nderin e shtetit", ka thënë Kilicdaroglu, ish-shërbyes civil. "Ju keni sjellë me qëllim mbi 10 milionë refugjatë në këtë shtet. Sapo të jem në pushtet, do t'i dërgoj të gjithë në shtëpi".

Ogan ka thënë se ai do ta mbështesë vetëm kandidatin që merret me çështjen e migrantëve dhe e lufton "terrorizmin" - referencë në Turqi për militantët kurdë.



Rusia sulmon Kievin për herë të nëntë këtë muaj

KIEV, 18 MAJ - Kryeqyteti i Ukrainës, Kiev, është goditur të enjten nga sulmet ajrore ruse për të nëntën herë këtë muaj. Një person është vrarë dhe dy të tjerë janë plagosur si pasojë e sulmeve raketore në Odesa, qytetin port në Detin e Zi, kanë thënë zyrtarët.

Shpërthimet janë dëgjuar edhe në disa qendra rajonale, Vinitsia, Kmelnitski dhe Zhitomir.

Administrata ushtarake e Kievit ka thënë se informacionet preliminare tregojnë se të gjitha raketat e nisura janë shkatërruar.

Kjo është hera e nëntë gjatë muajit që Rusia ka nisur sulme ajrore në kryeqytetin ukrainas. Të martën Ukraina ka thënë se i



ka rrëzuar gjashtë raketa hipersonike Kinzhal në kuadër të sulmeve "intensive".

Zyrtarët perëndimorë besojnë se ushtria e Ukrainës ka një gjendje të konsiderueshme gatishmërie për të nisur kundërofensivë ndaj forcave ruse.

Zyrtarët kanë thënë se ushtria e Kievit tani ka kapacitet për manovrim të tankeve, të pajisjeve luftarake, ka inxhinierë të rinj në fushëbetë, mund t'i pastrojë territoret nga minat, të ndërtojë ura të përkohshme për të kaluar lumenjtë dhe për të shënjestruar targete në distanca të gjata.

Ata kanë thënë se trupat ruse janë në gjendje "të pakëndshme", mirëpo kanë paralajmëruar se

forcat mbrojtëse të Moskës mund të kenë vendosur shumë mina në linjë të frontit. Prandaj, sipas tyre, sukcesi i ndonjë ofensive duhet të matet jo vetëm me fitore territoriale, por edhe nëse presidenti rus, Vladimir Putin, bindet që ta rishqyrtojë strategjinë e luftës.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Varhelyi kritikon Dodikun: Aleatët e BE-së nuk shkojnë në Rusi

Bruksel, 18 maj - Komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim i Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi, ka paralajmëruar Bosnjë-Hercegovinën se aleatët e BE-së nuk vizitojnë Rusinë. Këto deklarata ishin një tjetër shfaqje e zhgënjimit lidhur me vizitën që presidenti i Republikës Sërpska, Millorad Dodik, zhvilloi vitin e kaluar në Rusi. "Aleatët tanë nuk shkojnë në Rusi, ky është mesazhi im", tha Varhelyi në pyetjen e gazetarëve lidhur me vizitën e Dodikut. "Kush dëshiron të jetë aleat yni nuk shkon në Rusi".

Bosnja, që më 2016 kishte aplikuar për anëtarësim në BE, dhjetorin e vitit të kaluar mori statusin e shtetit kandidat pas shqetësimeve se lufta në Ukrainë mund të destabilizojë rajonin e Ballkanit. Megjithatë, shteti ka pranuar një listë të gjatë të

kushteve që duhet të përmbushë e të cilat synojnë ta forcojnë demokracinë në këtë shtet ballkanik. "Ne na duhet që Bosnjë-Hercegovina të jetë aleatja jonë", tha Varhelyi gjatë konferencës për medie në Sarajevë, pasi mori pjesë në një forum të nivelit të lartë politik, ku u diskutua për hapat që duhet të ndërmerret Bosnja që t'i bashkohet BE-së. Ai shtoi se është e rëndësishme që të dërgohet një mesazh i fuqishëm nga Bosnja që ky shtet të paraqesë një qëndrim të përbashkët.

Varhelyi lavdëroi përparimin e bërë "në një kohë rekorde" për formimin e qeverisë dhe miratimin e buxheteve pas zgjedhjeve të përgjithshme që u mbajtën tetorin e vitit të kaluar.

Ai, po ashtu, i inkurajoi politikanët në Bosnjë që t'i kryejnë reformat për të cilat janë



pajtuar kur kanë marrë statusin e vendit kandidat.

Por, deklaratat nga Dodiku së

bashku me udhëtimin e tij në Rusi, ku ai u takua edhe me presidentin rus, Vladimir Putin,

vënë në pah mungesën e unitetit në politikën e jashtme të Bosnjës. Dodik veçse është kritikuar nga blloku evropian, pasi në janar ai i dha Putinit çmimin më të lartë që jep entiteti i Republikës Sërpska. Ky vendim nxiti reagime dhe paralajmërimi se Bosnja duhet të jetë më e kujdesshme lidhur me sundimin e ligjit teksa aspiron t'i bashkohet bllokut evropian.

Dodik ka kundërshtuar sanksionet e vendosura ndaj Moskës për pushtimin e paprovokuar të Ukrainës dhe, po ashtu, kundërshton pranimin e pavarësisë së Kosovës.

Gjithashtu, ai ka tentuar të ndajë ushtrinë, policinë dhe administratën tatimore të Republikës Sërpska nga Qeveria qendrore e Bosnjës, veprime që janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Paqes të arritur në Dejton më 1995.

DËSHMITARËT E PROKURORISË NË GJYKATËN SPECIALE VAZHDOJNË TË DËSHMOJNË NË SEANCA TË MBYLLURA NË RASTIN E THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT

Mbrojtja e Thaçit del kundër seancave të mbyllura: Duam të merret vesh e vërteta

Në Gjykatën Speciale në Hagë është duke vazhduar procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Deri më tani janë marrë në pyetje pesë dëshmitarë të ZPS-së. Këta dëshmitarë kanë dhënë dëshmitë e tyre në seanca të mbyllura për publikun. Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, është shprehur i shqetësuar për mbajtjen e seancave të mbyllura. Ai ka thënë se një gjë e tillë është duke i shkaktuar probleme mbrojtjes së liderëve të UÇK-së. Ai ka kërkuar nga trupi gjyqësor i Speciales që seancat të jenë publike. Në këtë kontekst, avokati Kehoe ka thënë se duan të merret vesh e vërteta në lidhje me këtë proces gjyqësor

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 18 MAJ - Gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka nisur më 3 prill të këtij viti. Pas deklaratave hyrëse të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), mbrojtjes dhe liderëve të UÇK-së, ka nisur marrja në pyetje e dëshmitarëve të prokurorisë. Deri më tani janë dëgjuar vetëm pesë dëshmitarë. Të gjithë këta dëshmitarë janë marrë në pyetje nga prokuroria dhe mbrojtja në seanca të mbyllura gjyqësore. Mbrojtja e këtyre seancave është duke u përcjellë me shqetësim nga avokatët mbrojtës të liderëve të UÇK-së.

Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, të enjten, derisa ishte duke u marrë në pyetje dëshmitari i pestë i prokurorisë, ka shprehur disa shqetësime lidhur me seancat e mbyllura. Për shkak të urdhrat të trupit gjyqësor të seancës së 17 majit për zhvillimin e procedurave për seanca private apo të mbyllura, avokati Kehoe ka thënë se dëshiron të paraqesë disa vështrësi, duke theksuar se mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka kundërshtuar të gjitha masat e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) edhe për masat mbrojtëse. Avokati Kehoe ka thënë se marrjen në pyetje të dëshmitarëve dëshirojnë ta bëjnë në seanca të hapura për publikun. "Siç e keni vënë re, i kemi kundërshtuar të gjitha masat e përdorura nga ZPS-ja për seanca të mbyllura. Por, dua ta tërheq vëmendjen se jo vetëm se kundërshtojmë, sepse duam që procedurat të mbahen të hapura



e të merret vesh e vërteta, por kemi edhe shqetësime praktike në ndjekjen e metodave të përdorura nga ZPS-ja", ka thënë avokati Kehoe. Sipas tij, ZPS-ja ka mundësi të dalë dhe të futet në seancë private sa herë që e sheh të nevojshme dhe për të si mbrojtje paraqet vështrësi që të kalojnë sa në një pyetje në pyetjen tjetër. Më tutje, avokati i Thaçit ka thënë se këto vështrësi duhet të vlerësohen edhe për shkak se edhe dy dëshmitarët e tjerë me radhë kanë masa të mëdha

mbrojtëse.

Në këtë kontekst, avokati Kehoe ka thënë se një e gjë e tillë shkakton vështirësi që publiku të kuptojë se çfarë pyesin dëshmitarët pasi, sipas tij, procedura është shumë më e vështirë nga ana e tyre sesa nga ana e prokurorisë.

Lidhur me këtë çështje është deklaruar edhe ZPS-ja, duke thënë se shqetësimet kryesore nuk vijnë nga ata, por nga frikësimi i dëshmitarëve dhe se kjo nuk është diçka që mund të

parandalohet nga ta. Sipas ZPS-së, prokuroria ka rast që ka kërkuar që seanca të bëhet publike, por është kundërshtuar nga mbrojtja.

Ndaj këtij konstatimi të ZPS-së ka reaguar avokati i Thaçit, duke thënë se ata nuk pajtohen me këtë qëndrim, pasi këtë praktikë e kundërshtojnë me vite. Por, kryetari i trupit gjyqësor, gjykatësi Charles Smith, ka thënë se urdhri nuk është bërë për të fajësuar dikë, por nëse kjo nuk arrihet nga palët, do të bëjnë

vetë si trup gjyqësor.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga 5 nëntori i vitit 2020. Ata disa herë kanë kërkuar që të mbrohen në liri, por një gjë e tillë është refuzuar vazhdimisht nga Gjykata Speciale. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat me të cilat i ngarkon Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Naser Kelmendi dënohet 4 vjet e 8 muaj për trafikim të narkotikëve



PRISHTINË, 18 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin dënues ndaj Naser Kelmendit për trafikim të narkotikëve. Kelmendi u dënua 4 vjet e 8 muaj burgim, njoftoi kryetarja e trupit gjyqësor, Suzana Kelmendi. Ajo tha se në dënim do të llogaritet edhe koha që Kelmendi ka kaluar në paraburgim. "Koha e kaluar në privim lirie nga data 13 maj 2013 deri më 27 qershor 2017, si dhe nga data 1 shkurt 2018 deri më 24 korrik 2018, do të llogaritet në

shqiptimin e dënimit", tha Çerkini.

Aktgjykimin u shpall në mungesë të të akuzuarit. Më 2018 Gjykata Themelore në Prishtinë e shpalli fajtor Kelmendin për posedim të paautorizuar të narkotikëve me qëllim të shpërndarjes së tyre dhe e dënoi 6 vjet burgim. Në pikat e tjera të aktakuzës, që përfshinin akuza për krim të organizuar dhe vrasjen e Ramiz Delaliqit - shtetas i Bosnjës - Kelmendi u shpall i pafajshëm. Megjithatë, po atë vit Gjykata

e Apelit kishte kthyer në rigjykim pikën për të cilën Kelmendi u shpall fajtor.

Kelmendi, i lindur në Pejë, është shtetas i Bosnjë-Hercegovinës dhe fillimisht ishte arrestuar më 2013 nga Policia e Kosovës, bazuar në një fletarrestim ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet boshnjake.

Më 2012 Departamenti Amerikan i Thesarit identifikoi Kelmendin nën Aktin për bosët e narkotikëve të jashtëm si një trafikant i lëndëve narkotike.



Chollet u telefonon Kurtit dhe Vuçiqit për zbatimin e marrëveshjes bazë të dialogut

Këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka marrë në telefon kryeministrin Albin Kurti dhe presidentin serb Aleksandër Vuçiq, me të cilët ka biseduar për procesin e dialogut dhe për situatën në veri pas zgjedhjeve. Chollet është cituar t'i ketë thënë Vuçiqit se është e nevojshme të shmangen provokimet dhe konfliktet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas Zyrës së Kryeministrit, biseda e tyre është fokusua te zbatimi i plotë dhe i pakushtëzuar i marrëveshjes bazë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka biseduar me këshilltarin e lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, për dialogun me Serbinë dhe zgjedhjet lokale të mbajtura në veri. Në një komunikatë të lëshuar për medie, Zyra e Kryeministrit ka thënë se sa i përket dialogut, në fokus ka qenë marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë në shkurt të këtij viti. "Ata biseduan edhe për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me theks te zbatimi i plotë dhe i pakushtëzuar i marrëveshjes bazike, dhe për takimin e së hënës në Bruksel në nivel të kryenegociatorëve. Folën edhe për situatën në katër komunat në veri të Kosovës pas zgjedhjeve të 23 prillit dhe për finalizimin e procesit zgjedhor me rastin e mbajtjes së seancave konstitutive dhe betimit të kryetarëve të zgjedhur. Institucionet e Republikës së Kosovës mbesin të përkushtuara që të garantojnë

kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, dhe në të njëjtën kohë të sigurojnë mbarëvajtjen e shërbimeve ndaj qytetarëve", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Pajtueshmëria për aneksin është arritur në mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Zyra e Kryeministrit ka njoftuar se Kurti dhe Chollet kanë biseduar edhe për vizitën në Kosovë të administratores së USAID-it, Samantha Power, e cila, bashkë me kryeministrin Kurti dhe ministren Rizvanolli, shpallën ankandin e parë për parkun me energji solare me kapacitet prej 100 MW. "Në lidhje me këtë, këshilltari Chollet tha se ajo ishte ndarë me përshtypjet më të mira dhe e falënderoi kryeministrin për pritjen. Kryeministri u shpreh i nderuar dhe mirënjohës për vizitën e administratores Power dhe për mbështetjen e vazhdueshme të USAID-it dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën", ka njoftuar qeveria. Të enjten Chollet dhe i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, do të raportojnë para Komitetit të Senatit për Marrëdhënie me Jashtë lidhur me politikat

amerikane kundrejt Ballkanit Perëndimor. Të mërkurën Chollet ka biseduar edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ai është cituar t'i ketë thënë Vuçiqit se është e nevojshme që të shmangen provokimet dhe konfliktet mes Kosovës dhe Serbisë. Sipas Presidencës serbe, zyrtari i lartë amerikan ka thënë se është e rëndësishme që Kosova dhe Serbia të vazhdojnë të punojnë drejt normalizimit të marrëdhënieve dhe sërish ka dhënë mbështetjen e ShBA-së për procesin e dialogut, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. "Presidenti Vuçiq theksoi se Serbia vazhdon të jetë e përkushtuar për politikën e paqes dhe bashkëpunimit në rajon", është thënë në njoftimin e Presidencës serbe. Kosova dhe Serbia më 27 shkurt në Bruksel arritën marrëveshje për normalizim të raporteve, ndërkaq më 18 mars në Ohër u pajtuan për aneksin e zbatimit të saj. Por deri më sot asnjë veprim i zbatimit të saj në praktikë nuk është marrë dhe dialogu ka ngecur. Kosova po kërkon zbatimin e plotë të marrëveshjes, ndërkaq Serbia

zbatimin e Asociacionit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë kësaj jave ka thënë se formimi i Asociacionit është pjesë e marrëveshjes me Serbinë, por se marrëveshja për normalizimin e raporteve mes dy vendeve nuk e përmban vetëm nenin 7. Kurti ka thënë se pala e Kosovës e ka bërë të qartë edhe në takimin e së hënës në Bruksel se është e interesuar të zbatohet në tërësi marrëveshja, e jo vetëm neni 7 i saj, në të cilin flitet për formalizimin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe e, po ashtu, për sigurimin e "një niveli të përshtatshëm të vetëqeverisjes". "Serbia dëshiron që ne të përqendrohemi vetëm dhe vetëm te neni 7. Natyrisht se neni 7 është pjesë e marrëveshjes, por neni 7 nuk është marrëveshja dhe këtë gjë zëvendëskryeministri Bislimi e ka bërë të qartë mbrëmë në Bruksel. Gjithashtu, kemi theksuar se dëshirojmë një plan zbatimi i cili është i hollësishëm, konkret, i balancuar dhe gjithëpërfshirës. Nuk mund të jetë plani i zbatimit i sekuencuar për marrëveshjen që e kemi bërë vetëm në nenin 7. Sa i përket nenit 7, pala serbe e ka rikonfirmuar se asaj nuk i interesojnë as Kushtetuta as aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, por vetëm teksti që e ka nënshkruar ish-kryeministri Isa Mustafa", ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se ende nuk kanë marrë raport nga Bashkimi Evropian mbi denoncimet e Kosovës për shkeljet e

marrëveshjes nga ana e Serbisë. "Në takimin e 2 majit të nivelit të lartë unë i kam dorëzuar një dokument me të gjitha shkeljet e Serbisë edhe të marrëveshjes bazike të 27 shkurtit në Bruksel, por edhe të marrëveshjes së Ohrit, mirëpo deri më sot nga ndërmjetësit nuk kemi një qëndrim të denoncimit tonë mbi shkeljet e Serbisë. Ne jemi të interesuar për zbatim të plotë e të menjëhershëm të marrëveshjes, pa kushte dhe pa vonesa. Pra është problemi te pala tjetër e cila nga pesë pikat e preambulës dhe 10 nenet e marrëveshjes, ajo dëshiron që ne të përqendrohemi vetëm te neni 7", ka theksuar Kurti. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se kërkesat që Asociacioni të jetë parakusht për zbatimin e neneve të tjera të marrëveshjes Kosovë - Serbi nuk e ndihmojnë procesin e dialogut. Ajo ka theksuar se interpretimet e reja të BE-së që kërkojnë nga Kosova të dalë përtej asaj që është e shkruar në letër janë të gabuara. Përkritazi me këtë, presidentja Osmani tha se Kosovës nuk duhet t'i kërkohej të bëjë diçka që fare nuk është në marrëveshje. "Ne presim që BE-ja mos të kërkojë të zbatohen gjëra për të cilat nuk jemi pajtuar, ndërkaq të kërkohej pikërisht ajo për të cilën jemi pajtuar. Ne presim akoma që BE-ja të jetë e qartë për shkeljet e Serbisë. Deri më tani nuk e kemi parë një gjë të tillë", ka deklaruar Osmani.

Ambasadori amerikan ia përsërit Kurtit themelimin e Asociacionit

PRISHTINË, 18 MAJ - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier, është takuar të enjten me kryeministrin Albin Kurti. Pas takimit, ambasadori Hovenier ka bërë me dije se Kurti ia ka përsëritur kërkesën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Pata një takim me kryeministrin Kurti siç e

kemi rregullisht. Patëm një takim të gjatë duke diskutuar për një sërë çështjesh. Sot kaluam kohë duke diskutuar për procesin e dialogut dhe diskutuam për kryetarët e rinj të zgjedhur në veri si dhe kemi diskutuar edhe për sfidat ekonomike. Shtetet e Bashkuara janë të fokusuara ta mbështetnin Kosovën në shumë çështje si ato ekonomike,

luftën kundër korrupsionit dhe padyschim ta ndihmojmë Kosovën që të marrë vendin e saj në rrugën evropiane. Ia rikujtova atij një mesazh që e kemi dhënë tash e disa herë, se duhet të ecet përpara me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si dhe implementimin e pikave të tjera të marrëveshjes", ka thënë Hovenieri.



Vuçiqi: Kryetarët e komunave në veri të Kosovës nuk do t'i pranojmë kurrë



PRISHTINË, 18 MAJ - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë të enjten se është duke u kërkuar serbëve ta ruajnë paqen para betimit që do të bëjnë katër kryetarët e komunave në veri të Kosovës. "Nesër do të mbahet. Ata do të tentojnë të mbajnë seanca konstituive në ndërtesën në veri të Mitrovicës, për tri komuna, dhe të zgjedhin kryetarë të rremë, me mbështetje të Quint-it, të zgjedhur në zgjedhje të rreme. Po u kërkoj serbëve që ta ruajnë

paqen, pasi ata nuk do të pranohen kurrë si kryetarë", u ka thënë Vuçiqi gazetarëve në Novi Sad.

Vendet e Quint-it janë: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuara, Franca, Italia dhe Gjermania.

Vuçiqi ka treguar se një ditë më parë ka zhvilluar një bisedë telefonike me të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, me Këshilltarin e Lartë të Departamentit amerikan të

Shtetit, Derek Chollet dhe ambasadorin amerikan në Serbi, Christopher Hill. Sipas tij, në takim është diskutuar për situatën "e tensionuar në veri të Kosovës", e cila, sipas tij, është konstante.

Më 23 prill në komunat veriore, të banuara me shumicë serbe - Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok - janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme, të cilat janë bojkotuar nga popullata lokale serbe.

Beogradi zyrtar nuk i njeh rezultatet e këtyre zgjedhjeve dhe ato i ka konsideruar "jodemokratike dhe joligjore". Partia e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Serbe, ka bërë thirrje për bojkotim të këtyre zgjedhjeve.

Edhe Beogradi zyrtar e ka mbështetur bojkotin.

Sipas të dhënave të Komisionit Qendror Zgjedhor, në zgjedhje kanë dalë 1 567 votues apo 3.47 për qind e trupit zgjedhor.

Komunat në veri patën mbetur

pa kryetarë nga nëntori i vitit të kaluar, meqë përfaqësuesit serbë në atë zonë kanë dhënë dorëheqje nga vendet e tyre të punës për shkak të mospajtimit me një vendim të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe. Kryetarët e sapozgjedhur për komunat veriore të Kosovës - të gjithë të partive shqiptare - duhet ta kryejnë betimin dhe të hyjnë nëpër zyrat e reja, ndonëse ato kanë funksionuar sipas sistemit të Serbisë.

Osmani takon profesorin Murphy, e falënderon për mbështetjen në GjND

PRISHTINË, 18 MAJ - Presidentja Vjosa Osmani ka prititur në takim profesorin e të drejtës ndërkombëtare në Universitetin "George Washington" në Washington D.C., Sean D. Murphy, i cili ishte anëtar i ekipit përfaqësues të Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin që lidhet me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ky rast ishte një ndër fitoret më të mëdha në historinë e Kosovës, ku GjND konfirmoi se shpallja e

pavarësisë ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Në takim me presidenten Osmani u diskutua lidhur me punën e përbashkët që ishte bërë në atë kohë në mënyrë që Kosova t'i mblidhte argumentet e nevojshme që çuan në fitoren e Kosovës para kësaj gjykate si dhe për sfidat me të cilat Kosova po ballafaqohet edhe sot.

Presidentja Osmani ka shprehur mirënjohjen e popullit dhe institucioneve të Kosovës për kontributin e



profesorit Murphy dhe të gjithë ekipit të GjND-së dhe e ka njoftuar atë për disa prej nismave të rëndësishme të

institucioneve të Kosovës që kanë për qëllim fuqizimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Ndër të tjera, presidentja Osmani e ka urren profesorin Murphy për çmimin Doctor Honoris Causa në Universitetin e Prishtinës si mirënjohje për kontributin e dhënë në procesin gjyqësor në GjND. Në këtë drejtim Osmani ka shprehur gatiqësinë që të vazhdojë bashkëpunimi me profesorin Murphy edhe në të ardhmen.

Kërkohej paraburgim prej 30-ditësh për katër të dyshuar për fajde

FERIZAJ, 18 MAJ - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka njoftuar se ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30-ditësh për katër të pandehurit me inicialet B. M., A. H., B. K

dhe A. M., për shkak të dyshimit të bazuar të veprave penale "Fajdeja", nga neni 331, paragrafi 3, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, "Detyrimi" nga neni 328, paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe "Organizimi i skemave

piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", nga neni 294, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së. Të pandehurit, me vendim të Prokurorit të Shtetit, gjenden nën masën e ndalimit 48 orë për veprat penale të lartcekura.



SBASHK-u përgëzon Sindikatën e Policisë për anëtarësim në CESP



PRISHTINË, 18 MAJ - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka përgëzuar Sindikatën e Policisë për anëtarësim në Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP). Sipas SBASHK-ut, kjo është një arritje e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe mirënjohje për djemtë e vashat që me punë e përkushtim janë në shërbim të vendit dhe të qytetarëve. "Na gëzon shumë lajmi i botuar në medie, se Sindikata e Policisë së Kosovës është pranuar anëtare me të drejta të barabarta në Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP). Është kjo një arritje e Sindikatës së Policisë së Kosovës

dhe mirënjohje për djemtë e vashat që me punë e përkushtim janë në shërbim vendit dhe të qytetarëve. SBASHK-u ka respekt të lartë e meritore për policinë e Kosovës dhe shumë herë në angazhimet tona, duke kërkuar realizimin e kërkesave të anëtarësisë sonë, kemi mbështetur fuqishëm kërkesat e policisë që janë prezantuar nga sindikata e tyre duke kërkuar që ato të gjejnë zgjedhje meritore nga institucionet e shtetit. Kështu do të veprojmë edhe në të ardhmen sepse këtë e meritojnë djelmoshat dhe vashat që me krenari mbajnë uniformën e policisë sonë", është thënë në urimin e SBASHK-ut.

Hapet Pavijoni i Kosovës në edicionin e 76 të Festivalit të Kanës

PRISHTINË, 18 MAJ - Për të dymbëdhjetin vit me radhë Qendra Kinematografike e Kosovës paraqitet në tregun më të rëndësishëm të filmit 'Marche Du Film' në Festivalin e Kanës. Ndër të tjera, aty do të promovohen filmat e fundit të Kosovës në kategori dhe faza të

ndryshme të zhvillimit, takime me partner ndërkombëtarë të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të rëndësishme ndërkombëtare, producentë e distributorë. Pavijoni i përbashkët i Kosovës dhe Shqipërisë gjendet në Village International Riviera, nr. 134.



Pishina e Gërmisë hapet në qershor

PRISHTINË, 18 MAJ - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se pas 10 vjetësh pishinës së Gërmisë po i kthehet freskia. "Pishina po vjen me një ambient të ri:

guaskë të lyer, investime në amfiteatër dhe në terrenin sportiv, renovim të tualetit, shtretër për relaksim, gjelbërim të shtuar, si dhe me kënd të

ushqimit dhe aktivitete të shumta artistike për të gjitha grupmoshat. Pishina hapet në qershor", ka njoftuar komuna e Prishtinës.

Shtyhet për në vjeshtë vizita e shkrimtarit turk Orhan Pamuk

PRISHTINË, 18 MAJ - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar të enjten se vizita e planifikuar më 24 maj në Kosovë e shkrimtarit të njohur turk Orhan Pamuk është shtyrë për në vjeshtë.

Edhe pse ardhja e tij ishte e konfirmuar, planifikuar dhe organizuar deri në detajet e fundit, për shkaqe të tij personale, Pamuk ka kërkuar që vizita të aranzhohet për një datë tjetër. "Për arsye që

nuk varen nga unë, më duhet ta shtyj vizitën time të paraparë për këtë muaj, por definitivisht do të takohemi në këtë vjeshtë", ka thënë Pamuk në një video që ka shpërndarë MKRS-ja.



Pasiguria e të rinjve ul ndjeshëm martesat në Shqipëri



TIRANË, 18 MAJ - Në Shqipëri vitet e fundit po vihet re një fenomen shqetësues për studiuesit e zhvillimeve shoqërore, ai i rënies së numrit të martesave. Në dekadën e fundit ato janë tkurrur rreth 18 për qind krahasuar me atë paraardhëse dhe po kaq në vitin 2021, ose me rreth 4 000 më pak, krahasuar me mesataren e pesë vjetëve të fundit.

Studiuesit mendojnë se të rinjtë sot e shtyjnë moshën e martesës të kushtëzuar nga disa faktorë, që lidhen me karrierën, arritjet profesionale, punën dhe të ardhurat financiare. Sipas statistikave të INSTAT, sot papunësia në radhët e të rinjve të moshës 15 deri 29 vjeç është mbi 20 për qind, ose 10 pikë për qindje më e lartë se niveli i papunësisë në tërësi. Këta tregues, sipas ekspertëve, ulin mundësitë për krijimin e familjes dhe të sjelljes në jetë të fëmijëve.

“Zëri i Amerikës” pyeti disa qytetarë, mes tyre edhe të rinj, për këtë fenomen. Ata veçuan si

pengesën kryesore, për krijimin e martesës, mundësitë e kufizuara ekonomike. “Duhet parë zhvillimin e shoqërisë. Tani secili do të jetë i pavarur, martesa është obligim. Njerëzit kanë shumë pasiguri”, u shpreh Gresilda Merkaj, studente. “Pengesë është ekonomia e dobët, tradhtia. Të rinjtë nuk i besojnë më martesës, dashurisë. Besimi është shkëputur. Ka shumë faktorë që nuk arrijnë sot të rinjtë të binden për martesën”, tha Anxhela Kollozaj, studente. “Nuk martohen sepse nuk janë të sigurt, shtëpi s’kanë, punë s’kanë dhe nuk kanë siguri për jetën”, vijoi Xhevat Hysenaj, qytetar nga Tirana.

Sociologët vërejnë se në prag të një martese hyjnë disa faktorë në lojë, ku kryesoret janë puna, të ardhurat dhe strehimi. “Pyetja që ne shtrojmë është: A është e mundur që me të ardhurat mesatare ne të garantojmë mundësinë e të pasurit të një çatie mbi kokë? Kërkohet një siguri

kontraktuale. A është e mundur që ne sot të garantojmë këtë siguri kontraktuale? Fillimisht ne duhet t’i sigurojmë nevojat bazë dhe nevojat për siguri. Nevojat për siguri përktihen në nevojë për një kontratë pune të sigurt dhe nevojë për një strehë të sigurt”, u shpreh për “Zërin e Amerikës”, Ela Tollkuçi, psikologe sociale.

Arjana Muçaj, shefe e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë në Universitetin e Tiranës, ka theksuar se ka një disbalancë shumë të madhe mes të ardhurave që kanë të rinjtë sot dhe asaj çfarë ata duan të krijojnë në të ardhmen e tyre. “Dhe kjo ndonjëherë i bën ata të ndihen të paplotësuar”, tha Muçaj.

Një nga të dhënat që e bën më të vështirë situatën e të rinjve në vend lidhet me faktin se, sipas INSTAT, 26.1 për qind e të rinjve të grupmoshës 15-29 vjeç nuk janë as në punë dhe as në shkollë.

Autoritetet thonë se kanë marrë masa për ta ulur papunësinë dhe nxitit aftësimin profesional te të

rinjtë përmes disa nismave të posaçme. Sipas tyre, ka nisur të zbatohet një program për kodimin, që parashikon subvencionimin nga buxheti i kurseve për të rinjtë në këtë fushë, gjithashtu dhe ofrimin e kurseve falas për profesione të kërkuara në treg si hoteleri, turizëm, dizajn grafik dhe aftësi digjitale.

Mbështetje ofrohet edhe për çeljen e bizneseve të reja, dhe 50 për qind e përfituesve, thonë zyrtarët, aktualisht janë të rinj.

Edhe bizneseve që punësojnë të rinj të papunë u subvencionohet gysma e pagës për ta. Sipas tyre, fokus të veçantë këtë vit do ketë një program që aplikohet edhe në vendet e BE-së, ai i garancisë rinore. “Garancia rinore parashikon ofrimin e një mundësie punësimi brenda katër muajve, trajnimi ose edukimi për çdo të ri që është jashtë tregut të punës, pra i papunë, nuk është në një formim profesional ose nuk është në një proces edukimi”, u shpreh Klevis Hysa, drejtor i

Agjencisë Kombëtare të Punës dhe Aftësimin.

Bashkia më e madhe në vend, ajo e Tiranës, prej pesë vjetësh ofron disa lehtësira në strehim për çiftet e reja 25 deri 35 vjeç. Autoritetet lokale në kryeqytet u ofrojnë atyre kredi të buta, duke subvencionuar interesat e kredisë për blerjen e një banese. Deri tani kanë përfutur mbi 1 000 çifte të reja, thonë zyrtarët. “Çiftet e reja janë prioritet dhe te programet e reja të strehimit, siç janë bonusi i qerasë dhe banesat sociale, edhe pse realisht në disa programe synojmë shumë që një pjesë e mirë të jenë persona që janë pa të ardhura ekonomike apo nga grupe të tjera sociale, por gjithsesi çiftet e reja janë prioritet”, u shpreh Anisa Subashi, drejtoreshë e Shërbimit Social në Bashkinë e Tiranës.

Por sociologët thonë se kostot e jetesës po rriten çdo ditë në raport me mundësitë. Qeveria ka njoftuar rritjen e pagës mesatare në rreth 900 euro ose 67 për qind, ka rritur pagën minimale, pagën në disa sektorë publikë, por statistikave e papunësisë në radhët e të rinjve me 20 për qind i zbehin këto nisma.

Studiuesit vënë re me shqetësim se rënia e numrit të martesave po shoqërohet dhe me rritjen e divorceve, tregues që, sipas tyre, e vendosin familjen shqiptare në krizë. Zhvillimet e vrullshme social-ekonomike në vend, emigrimi, papunësia, informaliteti në ekonomi, kanë sjellë pasiguri të shumta, thonë ata, ndaj martesa nuk është në planet e të rinjve.

Kostot e kësaj krize kanë filluar të ndihen me rënie e numrit të lindjeve në vend, rritjen e moshës mesatare të popullsisë, pra plakjen e popullsisë, mungesën e fuqisë punëtore dhe raportin e zhdrejtë mes kontribuuesve dhe përfituesve në skemën e sigurimeve shoqërore.

Këta faktorë e dëmtojnë shoqërinë në terma afatgjatë, argumentojnë studiuesit, ndaj dhe masat e ndërmarra për parandalimin e tyre kanë ndikim të ulët në shoqëri.

Prokuroria e Prishtinës pranon kallëzim penal ndaj “Visa Metric”

PRISHTINË, 18 MAJ - Prokuroria Themelore në Prishtinë të hënën e 15 majit ka pranuar kallëzim penal ndaj kompanisë “Visa Metric” së cilës Gjykata Komeriale e Kosovës ia ka ndaluar të marrë nga 30 euro për shërbime postare për pasaportat e qytetarëve. Lajmin për “Telegraf”-in e ka konfirmuar zëdhënësja e kësaj prokurorie, Laureta Ulaj, e cila ka thënë se Prokurori i Shtetit menjëherë ka filluar ndërmarrjen e veprimeve në drejtim të veprës penale “Mosekzekutimi i vendimeve

gjyqësore”. “Lidhur me këtë çështje, të hënën Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar kallëzim penal. Prokurori i Shtetit menjëherë ka filluar ndërmarrjen e veprimeve sipas dispozitave ligjore të KPPRK-së në drejtim të veprës penale ‘Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore’, nga neni 394, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Për zhvillimet e radhës lidhur me këtë rast do të njoftoheni në kohë”, ka thënë Ulaj.

Ndonëse i ishte ndaluar me

vendim gjyqësor praktika e detyrimit të aplikantëve për ta paguar shërbimin postar në rastet kur aplikojnë për viza, kompania “Visa Metric”, e cila është e kontraktuar nga Ambasada e Gjermanisë, vazhdonte avazin duke i faturuar 30 euro aplikantët për shërbimin postar. Arsyetimi i kompanisë ishte se nuk e ka pranuar vendimin.

E të martën, plot një muaj pas marrjes së vendimit, “Visa Metric” njoftoi publikisht se e ka pranuar vendimin e gjykatës dhe se do ta respektojë.



Prodhimet organike të Kosovës shkojnë në tregjet evropiane



PRISHTINË, 18 MAJ - Rreth 95 për qind e prodhimeve organike, të cilat grumbullohen dhe kultivohen në Kosovë, gjejnë vend në tregun evropian. Pronari i një kompanie në Istog thotë se kërkesat për to janë shumë më të mëdha në vendet evropiane sesa në Kosovë. “Mesatarisht, në vit, në tregun evropian eksportojmë prodhime organike në vlerë rreth pesë milionë euro, ndërkaq në tregun e brendshëm shitja nuk arrin vlerën e 150 mijë eurove”, thotë Halit Avdijaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Avdijaj shton se vazhdimisht punojnë që prodhimet e tyre organike t'i fusin edhe në tregun vendës që, siç thotë ai, edhe popullata e Kosovës të përfitojë nga dobitë e tyre por kërkesat, sipas tij, janë ende të ulëta.

Kompania e Avdijajt, që kultivon dhe grumbullon prodhime organike, eksporton në Gjermani, Zvicër, Austri, Çeki, Bullgari, Francë dhe në Britaninë e Madhe.

Dy vjet më parë ajo ka filluar eksportin edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada, tregon Avdijaj.

Në kompaninë e Avdijajt kultivohen 32 prodhime organike, si kamomili dhe menta, dhe grumbullohen 72 prodhime të tjera, siç janë agulicet, lulja e shtogut, frutat e boronicës e të kaçës.

Në vitin 2022 Kosova eksportoi në tregun evropian prodhime organike me vlerë prej 15 milionë eurosh, sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë.

Që një prodhim nga Kosova të arrijë në tregun ndërkombëtar, kompania duhet jetë e certifikuar si kompani organike. Certifikimet e prodhimeve organike në Kosovë bëhen nga organe certifikuese ndërkombëtare.

Avdijaj thotë se për të certifikuar një prodhim organik kërkohen kritere të shumta. “Për të filluar një kultivim organik, fillimisht toka duhet të jetë e patrajtuar së paku gjatë pesë vjetëve të fundit, pastaj nuk duhet të ketë

në kufi ndonjë element ndotjeje. Janë shumë kritere dhe shumë vështirësi, dhe kërkohet punë mekanike”, tregon ai.

Rreth 50 kompani organike në Kosovë

Prodhimet organike prodhohen pa përdorimin e plehrave sintetike, hormoneve shtazore, aditivëve të dëmshëm dhe substancave toksike. Këto prodhime nuk i ekspozohen rrezatimit dhe nuk përmbajnë mbetje të antibiotikëve dhe barërave veterinarë.

Prodhimet organike identifikohen përmes logos, e cila e garanton integritetin e tyre organik.

Drejtori i shoqatës “Organika”, Fatmir Nagavci, thotë për “REL”-in se numri i kompanive të certifikuara si organike në Kosovë është rritur nga viti në vit, dhe se pothuajse të gjitha këto kompani i eksportojnë prodhimet e tyre në vendet evropiane. “Në vitin 2016 në Kosovë kanë qenë vetëm dy

kompani të certifikuara për prodhime organike. Vitin e kaluar numri i tyre ka arritur në afër 50 sosh”, tregon Nagavci.

Sipas inventarizimit të grumbullimit të prodhimeve pyjore jodrunore, të përpiluar nga Departamenti i Botanikës i Fakultetit të Matematikës dhe Shkencave Natyrore të Universitetit të Prishtinës, Kosova ka potencial për të grumbulluar së paku 29 mijë tonelata prodhime të tilla.

Inventarizimi tregon se 85 prodhime të tilla kanë potencial ekonomik dhe kontribuojnë në gjenerimin e të ardhurave dhe mirëqenien ekonomike të familjeve që jetojnë në zonat rurale. Por, ky potencial ekonomik, sipas shoqatës “Organika”, nuk shfrytëzohet. “Nga 29 mijë tonelata, sa është potenciali i grumbullimit të këtyre prodhimeve, vitin e kaluar janë grumbulluar vetëm rreth 3 500 tonelata”, thotë Nagavci.

Kosova i ka të gjitha kushtet për prodhimin e prodhimeve organike, thotë Fadil Millaku,

doktor i Shkencave të Biologjisë në Universitetin e Prishtinës. Por, fermerët, sipas tij, janë të dekurajuar që të pajisen me certifikata për shkak të procedurave të shumta që kërkohen për certifikimin e një prodhimi organik. “Potencial ka dhe përfitimet janë të mira, sepse të gjitha këto prodhime kanë treg të sigurt. Evropa dhe shtetet e tjera të zhvilluara çdoherë e më shumë po kërkojnë prodhime organike që janë të shëndetshme”, thotë Millaku për “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas një raporti mbi bujqësinë organike në Kosovë, të vitit 2022, të përpiluar nga Qendra Ndërkombëtare për Bujqësinë Organike, thuhet se “Kosova ka kushte të përshtatshme klimatike dhe tokësore për prodhime organike dhe se sektori organik është më premtues në Kosovë”. “Disponueshmëria e tokës së pastër ofron një bazë të mirë për zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara me prodhime organike”, thekson raporti.

Hapet panairi EXPOKOS

PRISHTINË, 18 MAJ - Është hapur të enjten në Prishtinë edicioni i 22-të i Panairit Ndërkombëtar “EXPOKOS”, në të cilin po marrin pjesë biznese të sektorit të ndërtimit, energjisë, makinerisë, mbrojtjes dhe sigurisë. Panairi do të qëndrojë i hapur edhe të premten në sallën “1 Tetori”. Përveç bizneseve vendore, ky panair ka sjellë në vend edhe

biznese nga Bashkimi Evropian, të cilët po i paraqesin bizneset e tyre.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se Kosova ka potenciale për investime falë fuqisë punëtore. Ajo ka theksuar se synojnë që Kosova të integrohet më shpejt në Bashkimin Evropian.

Organizatori i këtij panairi,

Bekim Xhafa, ka thënë se këtë vit numri i prodhuesve është në rritje. “Këtë vit jemi mirë për faktin se numri i prodhuesve është në rritje. Kemi shumë prodhues nga vendi të cilët janë në panair për të shtrirë dhe për të hapur dyer edhe jashtë kufijve të Kosovës. Me disa prej tyre kemi filluar të realizojmë edhe marrëveshje”, ka thënë Xhafa.



Afrimi me Kinën do t'i kushtojë jo pak Emmanuel Macronit



Nga Nicolas TENZER
"Center for European Policy
Analysis"

Gjatë vizitës së tij të pak ditëve më parë në Kinë, presidenti francez Emmanuel Macron tregoi dukshëm indiferencë ndaj fatit të Tajvanit. Madje e akuzoi SHBA-në për nxitjen e tensioneve. Fjalët e Macron bënë jo pak përshtypje, sepse nuk ishin as të pritshme e as të kërkuara.

Tani asnjë udhëheqës evropian nuk do të jetë në gjendje të shprehë indiferencë për Tajvanin, apo të imagjinojë një rrugë të tretë midis Amerikës dhe Kinës. Ashtu si me flirtin e kotë të presidentit francez para pushtimit të Ukrainës me Rusinë e Vladimir Putinin, ai ka krijuar përshtypjen e një lidhjeje me një konceptim strategjik të vjetruar, këtë herë me Kinën.

Duket se Macron i jep shpeshherë përparësi "fuqive të mëdha" mbi kombet e tjera. Ai nuk e vizitoi asnjëherë Kievin deri disa ditë para pushtimit rus. Tani po fajësohet se vlerëson Republikën Popullore të Kinës më shumë se sa Tajvanin, vendin e tetë më demokratik në botë sipas britanikes "The Economist".

Koncepti i tij i nënkuptuar për një hierarki midis vendeve, shpjegon edhe arsyen pse ai i kushtoi pak vëmendje paralajmërimeve të dikurshme për Rusinë e Putinin, të bëra jo rrallëherë nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe nga shumë ekspertë në vend. Presidenti francez përqafon idenë

se vendet kanë më shumë rëndësi se sa regjimet, gjë që në rastin e Rusisë e nxiti atë të refuzonte të merrte në konsideratë rreziqet e sigurisë që lidhen me ideologjinë revizioniste dhe shkatërruese të Putinin.

Pasi u paraqit si një mbrojtës i lirisë në një fjalim të vitit 2017 në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, dhe pasi theksoi në vitin në 2018, se të drejtat e njeriut janë universale dhe jo kulturore, ai ka bërë shumë pak për t'i mbrojtur këto vlera nga diktatorët. Macron pretendon se është e mundur që t'i vëmë diktaturat kundër njëra-tjetrës.

Në fillim të mandatit të tij të parë, ai u afrua me Rusinë e Putinin për t'iu kundërvënë Kinës, dhe për të parandaluar rënien e Kremlinit në prehrin e saj. Tani ai mendon se është e mundur të ecet përpara me Kinën me të ashtuquajturin planin e saj të paqes për Ukrainën. Por Ukraina nuk ka nevojë për një ndërmjetës. Ajo ka nevojë vetëm për aleatë që ta ndihmojnë të mposhtë pushtimin kriminal të Rusisë. Kina ka arsytet e veta që të mbështesë Putinin. Një ndryshim i regjimit do ta frikësonte Xi Jinping nga përhapja e valës demokratike. Kontrolli kinez mbi Rusinë – dhe Azinë Qendrore – do të jetë më i lehtë nëse Rusia udhëhiqet nga një regjim diktatorial.

Një Rusi e lirë, e ndihmuar nga demokracitë, do të ishte pre më e vështirë. Së fundi, Kina ka nevojë për regjimin e Putinin për të formuar një aleancë 'ad hoc' të fuqive revizioniste, m synim

minimin e rendit aktual ndërkombëtar dhe liritë themelore. Deklarata e presidentit francez kërcënojnë të sjellin pasoja të rrezikshme.

Së pari, siç theksoi dekani i Kolegjit të Studimeve Ndërkombëtare dhe të Sigurisë në Qendrën Marshall, Andreë Michta, ato nxisin ndjenja anti-evropiane në Kongresin e SHBA-së, të cilat mund të nxitin zvogëlimin e angazhimit të Uashingtonit në Ukrainë. Duke nënvizuar "mosmirënjohjen" e supozuar të presidentit francez, kongresmenët anti-evropianë synojnë që t'i japin përparësi ekskluzive Azisë.

Por një distancim i Amerikës nga Evropa është një lëvizje tepër e rrezikshme. Siguria e Evropës është thelbësore për interesin kombëtar të SHBA-së, sepse Rusia dhe Kina përbëjnë së bashku një kërcënim global për demokracinë. Nuk është çudi që organet e propagandës ruse dhe kineze janë kënaqur shumë duke i bërë jehonë deklaratave të Macron, në përpjekje për të krijuar të çara midis Evropës dhe SHBA-së dhe midis vetë vendeve evropiane.

Së dyti, ndërsa deklaratat e presidentit francez synonin me të drejtë të pohonin nevojën për të forcuar mbrojtjen evropiane, paqartësitë e mëparshme mbi Rusinë dhe ato aktuale mbi Kinën, ato mund t'i dobësojnë edhe përpjekjet afatgjata të Evropës në fushën e sigurisë. Disa partnerë të BE-së, sidomos Polonia, duket se janë të tunduara

ta bazojnë mbrojtjen evropiane vetëm tek lidhjet e ngushta me SHBA-në.

E megjithatë, gafat verbale të presidentit francez përfaqësojnë paradoksalisht një shans që Evropa të forcojë aleancën transatlantike, pa e minuar angazhimin e fortë të Evropës për mbrojtjen e saj. Tani kontinenti mund dhe duhet të pohojë pa mëdyshje se karakteri demokratik i një shteti, dikton botëkuptimin tonë mbi marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kjo është po aq e vërtetë për Ukrainën dhe Moldavinë sa edhe për Tajvanin. Ishulli është sot e vetmja Kinë demokratike. Institucionet e tij janë të lira; rotacioni politik është i mundur; dhe shoqëria tajvaneze është moderne dhe e përkushtuar ndaj lirisë njerëzore.

Në rast se lejojmë zhdukjen e një demokracie, kjo gjë do të dërgonte një argument të fortë për diktaturat në lidhje me mospërputhjen dhe mungesën e shtyllës kurriore të demokracive. Ndërkohë Tajvani është një vend shumë strategjik.

Rreth gjysma e flotës globale të kontejnerëve kalon përmes Ngushticës së Tajvanit. Ishulli luan një rol të domosdoshëm në furnizimin më gjysmëpërçues: prodhon 59 për qind të tregut botëror, kundrejt 12 për qind nga SHBA dhe 10 për qind nga Evropa.

Nëse Evropa synon ta kufizojë varësinë e saj nga Kina, atëherë Tajvani përfaqëson një mundësi të madhe. Tashmë, shenjat

pozitive janë të dukshme. Franca veproi për të siguruar aleatët e saj duke dërguar një fregatë për të patrulluar Ngushticën e Tajvanit gjatë stërvitjeve më të fundit ushtarake kineze.

Iluzionet në lidhje me kërkimin nga Evropa të një autonomi strategjike – një koncept me shumë kuptime – janë zhdukur. Pas vizitës në Kinë, presidenti francez dhe këshilltarët e tij u munduan të justifikohen se nuk mund të ketë një politikë të baraslarguar midis Rusisë dhe Kinës, dhe se ata janë ende pro statuskuosë në lidhje me Tajvanin. Pavarësisht dallimeve të rëndësishme që e ndajnë Evropën dhe SHBA-në në fushën e tregtisë, sidomos Akti i Reduktimit të Inflacionit, apo edhe në disa çështje të politikës së jashtme – si Lufta e dytë e Gjirit në vitin 2003 – Evropa e kupton se lidhjet transatlantike mbeten thelbësore kur përballen me kërcënime ekzistenciale të sigurisë.

Koncepti i përdorur shpesh nga presidenti francez i krijimit të një "fuqie balancuese", nuk ka asnjë rëndësi në përmbushjen e kërcënimeve të tilla. Vullneti ynë i përbashkët për të siguruar fitoren e Ukrainës dhe humbjen totale të Rusisë, përbën një provë që aleatët tanë në Azi do të na vëzhgojnë me kujdes sesi sillemi.

Shënim: Nicolas Tenzer, anëtar i Qendrës për Analizën e Politikave Evropiane (CEPA) dhe profesor në Shkollën e Parisit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sonte finalja e plejofit në mes të Istogut dhe Vushtrrisë

“Epoka e re”

PRISHTINË, 18 MAJ - Ndeshja finale e plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll (femrat) në mes të Istogut dhe Vushtrrisë do të luhet sonte (e premte) prej orës 20:00 në palestrën e qytetit në Istog. Faruk Shala, trajner i Istogut, ka thënë se pret që palestra të jetë e mbushur me shikues dhe trofeu të mbetet në Istog. “Presim që palestra në Istog të jetë plot. Është ndeshje finale, vendoset titulli i kampionit të Kosovës, andaj skuadra është shumë e motivuar për lojë. Kishim rrjetë shumë të mirë të

kampionatit, që edhe ishte synimi ynë”, ka thënë Shala, i cili nuk ka fshehur respektin për rivalin. “Vërtet kam shumë respekt për skuadrën dhe vashat e Vushtrrisë. Ato janë treguar shumë këmbëngulëse. Edhe pse kanë humbur ndeshjen e parë gjysmëfinale, kanë arritur të kthehen duke zhvilluar edhe vazhdimet në ndeshjen e tretë. Është skuadër që nuk ndalet për 60 minuta. Pres që finalja në Istog të jetë e fortë. Shpresoj që edhe këtë vit të dalim kampionë dhe trofeu i çmueshëm të mbetet në qytetin tonë, tashmë qendër e rëndësishme e hendbollit në vend”, ka shtuar Shala.



Ndërsa trajneri i Vushtrrisë, Arben Parduzi, ka shprehur optimizëm se skuadra e tij do të shpallet kampione e Kosovës. “Synimet e klubit Vushtrria gjithmonë janë për ta fituar titullin e kampionit. Këtë

vit e kemi përtërirë ekipin. Kemi disa lojtare të reja që premtojnë shumë. Kemi luajtur gjatë gjithë kampionatit me synim që të arrijmë në plejof dhe sa më lart në Kupën e Kosovës. Mendoj se kishim

edicion të suksesshëm. Jemi paraqitur në finale të Kupës së Kosovës dhe tashmë jemi në finale të plejofit”, ka thënë Parduzi, i cili më pas ka vlerësuar se Istogu është favorit në këtë ndeshje, por Vushtrria do të japë maksimumin për të dalë triumfuese. “Në bazë të fondit të lojtareve që ka Istogu, mendoj se kjo skuadër është favorite. Por ne do ta japim maksimumin në çdo ndeshje që të arrijmë më të mirën e mundshme. Jam shumë i kënaqur me atë që kanë shfaqur vajzat deri më tani, por ne nuk do të ndalemi asnjëherë”, ka shtuar Parduzi.

KB Peja, kampione e Kosovës në basketboll



Mitrovicë, 18 maj - KB Peja është kampionia e re e Kosovës në basketboll. Këtë sukses klubi pejan e arriti pasi e mposhti skuadrën e Trepçës në ndeshjen e pestë finale me rezultat 91:93 (17:21, 17:15, 24:22, 19:19, 14:16), në njërin nga finalët më interesante pasluftës në basketbollin e Kosovës. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë me një seri prej 8:2, por mysafirët u kundërpërgjigjën shpejt për 11:12, ndërsa deri në fund të çerekut të parë u zhvillua lojë e barabartë, por përfundoi me

epërsinë e pejanëve 17:21. Lojë pothuajse e barabartë u zhvillua në periudhën e dytë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej, ku pjesa e parë përfundoi 34:36. Pejanët e filluan pjesën e dytë, përkatësisht periudhën e tretë më mirë, me epërsi prej tetë pikësh, 41:48, por mitrovicasit nuk u dorëzuan dhe deri në fund të kësaj pjese barazuan rezultatit në 58:58. Në çerekun e fundit u zhvillua lojë për infarkt. Herë kalonte njëra skuadër në epërsi e herë tjetra, ndërsa Joseph i Pejës shënoi shtatë pikë në fund, duke

kaluar në epërsi 75:77, por në sekondat e fundit, Amin Hot shënoi dhe ndeshja shkoi në vazhdimet 77:77. Edhe në vazhdimet u zhvillua lojë tepër interesante dhe dramatike, ndërsa përfundoi 91:93, me dy pikë në fund nga Brad Waldow. Jalen Tate është zgjedhur MVP i finaleve, ndërsa medaljet e arta dhe të argjendta i kanë ndarë Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe nënkryetarja e FBK-së, Linda Shala. Fetahu ka dorëzuar edhe trofeun e titullit për kapitenin e Pejës, Artij Hajdari.

Sevilla dhe Romës kualifikohen në finale të Ligës së Evropës

SEVILLE, 18 MAJ - Sevilla ka eliminuar Juventusin nga Liga e Evropës. Sfida e parë kishte përfunduar 1-1, ndërsa të enjten në mbrëmje triumfoi 2-1 skuadra spanjolle. Dusan Vlahović shfrytëzoi në maksimum një pasim të Rabiot në minutën e 64-të, për të zhbllokuar shifrat me një të

majtë të lehtë, me sferën që kaloi pas shpinës së marokenit Bono. Vendasit nga Sevilla vendosën ekuilibrat me ish-sulmuesin e Milanit, Suso. Spanjollit provoi me një të majtë fantastike nga larg, duke bërë të pamundur atë top për t'u mbërritur nga Szczesny. Në shtesa, Lamela i dha kualifikimin në finale

Sevillas. Ndërsa edhe Roma është kualifikuar për në finalen e madhe. Skuadra e drejtuar nga Jose Mourinho kishte fituar 1-0 ndaj Bayer Leverkusen në Itali, ndërsa në Gjermani u mjaftuan me një barazim pa gola. Finalja e Ligës së Evropës 2022/23 do të zhvillohet në “Puskas Arena” të Budapestit më 31 maj 2023.




Krasniqi: Gjithmonë e kam ndier obligim të boksoj në Kosovë

PRISHTINË, 18 MAJ - Ish-kampioni i botës në boksion profesionist, Robin (Haxhi) Krasniqi, mezi po e pret duelin e radhës i cili do të zhvillohet në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë më 5 gusht. Boksieri junikas ka thënë se gjithmonë e ka ndier obligim të boksoj në Kosovë dhe tash kjo ëndërr po bëhet realitet. “Si bir i

prindërve shqiptarë, si fëmijë i luftës në Kosovë dhe si kampioni i parë botëror me prejardhje shqiptare në boksion profesionist, gjithmonë e kam ndier obligim të bëj një mbrëmje të madhe të boksit në Prishtinë dhe tani ka ardhur koha, të dashur fansa dhe miq! Luftën e radhës do ta bëj në stadiumin e futbollit

të Prishtinës (stadiumin ‘Fadil Vokrri’) më 5 gusht 2023, duke i ofruar një ngjarje të madhe atdheut tim. Unë po e pres me padurim këtë mbrëmje dhe shpresoj të kem bërë të lumtur edhe shumë prej jush, miq të dashur”, ka shkruar Krasniqi, i cili synon ta rikthejë titullin e kampionit të botës.



Mitrovica, fituese e Kupës së Kosovës

PRISHTINË, 18 MAJ - Futbollistet e Mitrovicës e kanë fituar trofeun e parë të këtij edicioni për futbollin e vajzave. Ato në finalen e Kupës së Kosovës e kanë mundur skuadrën e EP Hajvalisë, me rezultat 2-1. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në

Prishtinë, solli rivalitet dhe lojë interesante nga të dyja ekipet. Të parat në epërsi kaluan mitrovicaset, të cilat realizuan përmes Edona Kryeziut, në minutën e 10-të. E njëjta futbolliste paraprakisht qëlloi tërthorësen pas gjuajtjes me kokë

në minutën e 4-t. Skuadra e drejtuar nga Suad Keqi pati mundësi të mirë për të barazuar shifrat në minutën e 34-t, por Fortesa Berisha në një përballje direkte me portieren Viona Rexhepi nuk doli e suksesshme. Megjithatë, vetëm tre minuta më

vonë ishte Qëndresa Krasniqi, e cila i barazoi shifrat, duke çuar skuadrat në pushim me shifrat e barabarta, 1-1. Për fitoren e skuadrës së Mitrovicës u përkuqdes Donjeta Halilaj, e cila në minutën e 79-të shënoi për rezultatin përfundimtar 2-1.



Ancelotti: Kjo humbje në forcon për vitin e ardhshëm. Guardiola: Finalja ndaj një ekipi italian gjithmonë e vështirë

MANCHESTER, 18 MAJ - Real Madridi u eliminua nga Liga e Kampionëve, pasi humbi ndeshjen kthyesë nga Manchester City (4-0). Trajneri Carlo Ancelotti e ka pranuar se skuadra angleze luajti më mirë, por ka thënë se kjo humbje do të bëjë më të fortë skuadrën e Realit në sezonin e ardhshëm. "Ata luajtën më mirë se ne dhe e meritonin të arrinin në finale. Nuk kishte qark të shkurtër, ata ishin të fortë, shtynë fort dhe kaluan në epërsi në pjesën e parë. Kjo humbje nuk e vë në dyshim atë që është bërë. E ardhmja ime është shumë e qartë dhe kjo humbje do të na ndihmojë të jemi më të mirë vitin e ardhshëm. Nuk ka dramë, le të shohim nga e ardhmja. Vitin e kaluar fituam, këtë vit jemi jashtë dhe në futboll ndodh kjo", ka thënë Ancelotti. "Në pjesën e dytë u përpoqëm të ktheheshim në lojë dhe ishte e pamundur. E prisja atë fillim, pastaj duhej ta menaxhonim më mirë ndeshjen. Por ne gjetëm një rival të fortë dhe duhet të pranojmë që na



eliminuan nga gjysmëfinalja. Ne nuk kemi mundur të luajmë një tjetër finale, por kemi bërë mirë këtë sezon dhe do të bëjmë më mirë sezonin e ardhshëm", ka shtuar Ancelotti. Në anën tjetër trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola është shprehur i lumtur se skuadra e tij do të luajë në finalen e Stambollit. Ai thotë se City nuk do ta këtë aspekt të lehtë kundër Interit. "Liga e Kampionëve ëndërr apo fiksime? Është speciale, është thjesht speciale.

Jam i lumtur, nuk është se ndodhë çdo ditë të arrish këtë objektiv, por tani duhet të përqendrohemi në kampionat dhe në Kupë, më pas do të mendojmë për Stambollin. Interi në finale? Një finale kundër një ekipi italian nuk është kurrë ndeshja më e mirë e mundshme. Duhet të përgatitemi shumë mirë psikologjikisht, por kemi kohë për këtë", ka thënë Guardiola. Finalja zhvillohet më 10 qershor në Stamboll.

Miami e fiton finalen e parë ndaj Bostonit

BOSTON, 18 MAJ - Miami Heat, i ardhur nga faza "play-in", vijon të befasojë në fazën "play-off", duke fituar me rezultat 123-116 ndaj Bostonit në finalen e parë të Konferencës së Lindjes. Ndeshja e luajtur në fushën e Celtics ishte e ekuilibruar dhe me emocione, por në fundin e saj triumfoi Miamin, që udhëheq 1-0 serinë. Tjetër ndeshje e shkëlqyer për Jimmy Butler, që realizoi 35 pikë për miqtë, mbështetur edhe nga Adebayo me 20 pikë. Ndërkohë që, katër lojtarë të Miamit realizuan 15 pikë: Strus, Vincent, Martin e Lowry. Për Boston u dallua Tatum me 30 pikë, por që s'mjaftuan për të fituar.

Konferenca e Lindjes, "Play-off" - Finale
Boston - Miami 116-123 (0-1)

Konferenca e Perëndimit, "Play-off" - Finale
Denver - Lakers (1-0)



Al Hilali 'tremb' Barcelonën, rrit ofertën për Messin

Barcelona po kërkon të rikthejë Lionel Messin këtë verë, por misioni i tyre pritet të jetë shumë i vështirë për shkak të konkurrencës nga klubi arab Al Hilali që duket se nuk do të kursejë asgjë. Gara për

nënshkrimin e tij është oferta më e madhe që i është bërë ndonjë futbollisti ndonjëherë, sipas Jaume Roures. Roures, i cili është kreu i Mediapro dhe mban të drejtat e transmetimit për La Liga, i tha Cadena SER se

oferta e Messit ishte rritur. Raportimet e mëparshme kishin vendosur shifrën në rreth 400 milionë euro për një kontratë dyvjeçare, por Roures deklaroi se ata e kishin rritur ofertën e tyre me 100 milionë

euro shtesë. Për kontekstin, Barcelona mendohet se ofron diku rreth 14 milionë euro në vit për Messin, mbi 35 herë më pak se sa Roures pretendon se Messi do të fitonte në Lindjen e Mesme. Messi u largua nga

Barcelona pas më shumë se 15 vjetësh në verën e vitit 2021 për t'u transferuar te Paris Saint-Germaini. 36-vjeçari ka kontratë valide me gjigantin francez deri më 30 qershor të këtij viti.

SHKURT

Lajm i mirë për Shqipërinë, Gjimshiti është gati për ndeshjet e qershorit

Lajme të mira për Kombëtaren e Shqipërisë nga Berat Gjimshiti. Mbrojtësi i skuadrës nga Bergamo u largua i lënduar nga fusha e lojës në përballjen e fundit mes Atalantës dhe Salernitanës, por me sa duket nuk bëhet fjalë për një problematikë serioze. Shtatlarti, në seancat e fundit është integruar me grupin, duke rritur mundësinë që të jetë pjesë e skuadrës që në përballjen e kësaj fundjave me Veronën. Shtatlarti është një nga lojtarët më të rëndësishëm të Atalantës, por gjatë këtij sezoni ka pasur disa herë shqetësime fizike. Lajmi i mirë dhe për Kombëtaren e Shqipërisë, pasi pritet që Gjimshiti të jetë pjesë e listës së Sylvinhos për dy ndeshjet e muajit qershor.

Shefi i Mercedesit: Hamiltoni do të fitojë titullin e tetë me ne


E ardhmja e Lewis Hamilton është e paqartë për shumë vetë por jo për shefi i Mercedes, Toto Wolff. Ai konfirmon se 7 herë kampioni i botës në Formula 1 do të vijojë të garojë për makinën gjermane. Jo vetëm kaq, por Hamiltoni synon titullin e tetë kampion me Mercedesin. "Mendoj se ai ndihet shumë i fortë. Të gjithë e dinë se këtë vit nuk do të kemi mundësi të konkurrojmë për titullin kampion për pilotë, por e ardhmja është ndryshe. Duhet vetëm t'i ofrojmë një makinë që të jetë e aftë të fitojë titullin, një paketë fituese dhe më pas ai e di se çfarë duhet bërë", ka thënë Toto Wolff. "Ai do ta fitojë titullin e tetë kampion me ne. Nuk kam asnjë dyshim që Lewis është i motivuar për ta arritur këtë gjë me ne. Kjo është ajo që ai dhe ne duam. Personalisht kam një marrëdhënie shumë të mirë me të dhe skuadra e do. Ka mbi 10 vjet me ne dhe do ta vazhdojmë bashkëpunimin", u shpreh Wolff.

Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Të mërkurën është mësuar edhe finalisti i dytë i Ligës së Kampionëve këtë sezon, me Manchester Cityn që e shkatërroi Real Madridin me rezultatin 4-0 në "Etihad". Faqja e njohur "Sofascore" ka publikuar formacionin më të mirë të javës në ndeshjet e dyta gjysmëfinale. Ky formacion dominohet nga lojtarët e Cityt, duke filluar nga porta me Ederson, pastaj në mbrojtje: Akanji, Dias dhe Walker. Pjesa e mesfushës është e terë me lojtarët e klubit të Cityt me Grealish, Gundogan, De Bruyne dhe Bernardo Silva. Kurse në fazën e sulmit, është dyshja e Interit: Lautaro Martinez dhe Romelu Lukaku. Kujtojmë që finalja e madhe e Ligës së Kampionëve zhvillohet më 10 qershor.

Liverpooli konfirmon largimin e katër lojtarëve në verë

Edhe pse gjithmonë kanë qenë në zërat e afatit kalimtar, duket se katër lojtarë nuk do të jenë më pjesë e Liverpoolit nga sezoni i ardhshëm, një lajm që është konfirmuar vetë nga ana e "Reds"-ave. Me anë të një postimi në rrjetet sociale, klubi anglez ka bërë me dije se Roberto Firmino, James Milner, Naby Keita dhe Alex Oxlade-Chamberlain i kanë dhënë fund aventurës së tyre në "Anfield". Të katërt ata do të largohen me parametra zero, teksa tani kanë nisur nga puna për të gjetur një skuadër të re.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

UDHËHEQËS/E I/E ZYRËS LIGJORE

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 07/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Koordinon, menaxhon dhe mbikëqyr punën e Zyres Ligjore të OMK-së;
- Ofron udhëzime dhe këshilla profesionale në kuadër të Zyres Ligjore;
- Harton dhe zhvillon legjislacion, akte normative si dhe akte të tjera juridike, kontrata, marrëveshje të cilat dalin nga fushëveprimtaria e OMK-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës;
- Siguron që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të përgatitura nga ZL të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;
- Drafton opinione/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme ligjore kërkuar nga organet e ndryshme me aktivitetet e Odës;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për stafin dhe organet e OMK-së;
- Harton raportet e punës të Zyres Ligjore;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme si dhe aktet e brendshme të OMK-së.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të jetë i diplomuar në Fakultetin Juridik, apo të avancuar (studime master);
- 3 (tre) vite përvojë pune menaxheriale;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!


Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **18.05.2023** deri më **02.06.2023, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E I/E LARTË EKZEKUTIV PRANË ZYRËS SË KRYETARIT

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 06/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimë dhe kopjimin e dokumenteve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe shkresat elektronike për punëdhënësin;
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së punëdhënësit;
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve të tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
- Pranon palët për Kryetarin e OMK-së dhe udhëheqësit tjerë të Odës, orienton palët te personat kompetent, dhe
- Kryen edhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga punëdhënësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Kryetari i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme profesionale në lëmi administrative, përparsi konsiderohet të fakulteti;
- 1 (një) vitë përvojë pune;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze obligative;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!


Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **18.05.2023** deri më **02.06.2023, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

SEKRETAR/E I/E PËRQJITHSHME I/E ODËS

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 05/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron këshilla të politikave për Kryetarin dhe organet e tjera të OMK-së;
- Siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të organeve të OMK-së të zbatohen në mënyrë efektive dhe efektive;
- Siguron që masat zbatuese të Odës të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave;
- Lëshon urdhëresa dhe udhëzime për kryerjen e punëve me miratim të organeve të OMK-së;
- Menaxhon personelin e Shërbimit Profesional;
- Menaxhon rrjedhën e informacionit në OMK;
- Bashkëpunon me sekretarët e Odave tjera në baza të rregullta;
- Koordinon raportin e organeve të OMK-së me organet e saj vartëse administrative; dhe
- Kryen edhe punë të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kërkesës së Kryetarit të OMK-së dhe Këshillit Drejtues të OMK-së.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Kryetari i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të jetë i diplomuar në ndonjërin nga degët e fakulteteve si: Mjekësi, Juridik, Ekonomik, Administratë Publike apo të avancuar (studime master të fushës e menaxhimit);
- Të ketë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të standardeve të integritetit, ndershmërisë dhe drejtësisë;
- Së paku 5 (pesë) vite përvojë pune menaxheriale pas diplomimit;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **18.05.2023 deri më 02.06.2023, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300 apo 038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ASISTENT/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 08/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjeve të komisioneve të përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e takimeve;
- Mirëmbanë dosjet e komisioneve të përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlidhen me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe shërbimit profesional në përgjithësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësit të Zyrës Ligjore

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme profesionale në lëmi administrative, përparsi konsiderohet fakulteti;
- Një (1) vitë përvojë pune në administratë;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **18.05.2023 deri më 02.06.2023, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300 apo 038/544-872.**



Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të nenit 12 dhe nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, dispozitive të Ligjit nr. 05/L-078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, dispozitive të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. shpall këtë:

KONKURS PUBLIK PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Për pozitën:

I. Inkasant/e, dy (2)

Departamenti i Operimeve, Divizioni i Parkingjeve me Laura

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Inkasimi i pagesave për shfrytëzim të parkingut, menaxhimi i faturave dhe të hollave;
- Identifikimi i konsumatorëve të rinj, përcjellja e konsumatorëve ekzistues;
- Ngarkimi me fatura, dorëzimi i pazareve ditore çdo ditë;
- Mbajtja e shënimeve për secilin konsumator, përfshirë kërkesa, ankesa, rekomandime dhe delegimi i tyre për shqyrtim;
- Realizimi i normës së inkasimit sipas akteve normative në fuqi të Ndërmarrjes.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë shkathtësi kompjuterike elementare.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin për punësim;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë se është person me aftësi të kufizuara.

Kohëzgjatja e kontratës - gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

Mënyra e aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore **me aftësi të kufizuara**, të cilët kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. **Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. rr. "Luan Haradinaj", p.n., Pallati i Rinisë (ish ASK), 10000, Prishtinë, Kosovë.**

Aplikacioni merret në selinë e N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. apo mund të shkarkohet në faqen zyrtare www.prishtinaparking.net. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi është i hapur për periudhën kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data: 19.05.2023 deri më 02.06.2023, ora 16:00.



Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Na temelju članka 12. i članka 13. Zakona br. 03/L-019 o osposobljavanju, stručnoj prekvalifikaciji i zapošljavanju osoba s invaliditetom, odredbe Zakona br. 05/L-078 o izmjenama i dopunama Zakona br. 03/L-019 o osposobljavanju, stručnoj prekvalifikaciji i zapošljavanju osoba s invaliditetom, odredbe Zakona br. 03/L-212 o radu i članak 4. Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru, lokalno javno poduzeće "Prishtina Parking" SH.A. najavi ovo:

JAVNI NATJEČAJ ZA OSOBE SA INVALIDITETOM

Za poziciju:

I. Sakupljač, dva (2)

Odjel za operacije, Odjel za parkiranje s Laurom

Dužnosti i odgovornosti:

- Naplata plaćanja za korištenje parkirališta, upravljanje računima i gotovinom;
- Identifikacija novih kupaca, praćenje postojećih kupaca;
- Naplata putem računa, dostava dnevne kupovine svaki dan;
- Vođenje bilješki za svakog kupca, uključujući zahtjeve, pritužbe, preporuke i njihovo delegiranje na pregled;
- Ostvarivanje stope naplate prema važećim normativnim aktima Poduzeća.

Osposobljenost i stručno osposobljavanje:

- SSS;
- Poželjno je radno iskustvo;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Poželjno osnovno poznavanje rada na računaru.

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Zahtjev za zapošljavanje;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i uvjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK-a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Dokaz da je osoba s invaliditetom.

Trajanje ugovora – šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost produljenja na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

Način primjene:

Pravo prijave imaju svi punoljetni državljani Republike Kosovo **sa invaliditetom**, koji su završili odgovarajuće obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti. Ispunjeni dokumenti moraju se dostaviti na adresu lokalnog javnog poduzeća "Prishtina Parking" SH, ul. "Luan Haradinaj", p.n., **Palata mladosti (bivši ASK), 10000, Prishtina, Kosovo.**

Prijava se zaprima u sjedištu N.P.L. "Prishtina Parking" dd. ili se može preuzeti sa službene stranice www.prishtinaparking.net. Kandidati koji se natječu dužni su unijeti točnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Samo odabrani kandidati bit će pozvani na razgovor.

Prijave dostavljene nakon roka ne prihvaćaju se, dok se nepotpune prijave odbacuju.

Natječaj je otvoren u trajanju od 15 (petnaest) dana od: 19.05.2023 do 02.06.2023 do 16:00 sati.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues